

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 8.10.2019

Lënda: REKOMANDIME LIDHUR ME PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN ZGJEDHOR

**Drejtuar: Z. DAMIAN GJIKNURI DHE ZNJ.RUDINA HAJDARI
BASHKËKRYETARË TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN ZGJEDHORE**

**Për dijeni: ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN ZGJEDHORE
PREZENCËS SË OSBE NË TIRANË**

**Z.KLEMENT ZGURI, KRYTETAR I KQZ
Z. IVI KASO, SEKRETAR PËR ZGJEDHJET NË PD**

Të nderuar bashkëkryetarë të Komisionit,

Në emër të Institutit të Studimeve Politike (ISP) dëshirojmë t'u shprehim falënderimin tonë për gatishmërinë që Komisioni ka treguar në bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe tërheqjen e opinionëve të ndryshme civile lidhur me reformën zgjedhore.

Njëherësh ju vëmë në dijeni se gjatë vitit 2019, Instituti i Studimeve Politike ka aplikuar projektin e monitorimit të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatën elektorale, me fokus qeverinë qendrore dhe bashkitë Vlorë, Kamzës e Durrës. Aktiviteti është mbështetur nga programi i USAID-it në Shqipëri (ACDC-Accelerated Civil Development und Cooperation). Të dhënat e detajuara të raportimit dhe të gjetjeve do të jenë publike përmes një raporti përfundimtar.

Përmes këtij komunikimi ne po ju dërgojmë bashkëngjitur disa nga problematikat kryesore, për të cilat ne mendojmë se do të duhet të ketë vëmendje dhe përgjigje në procesin e realizimit të reformës së re zgjedhore. Disa prej problematikave kërkojnë ndërhyrje në Kodin Zgjedhor, disa kërkojnë ndjekjen e standardeve më të larta e transparente në zbatim të legjislacionit në fuqi, disa të tjera lidhen edhe me legjislacionin plotësues zgjedhor në Shqipëri.

Ne shpresojmë se rekomandimet do të merren në konsideratë nga ana juaj.

Sinqerisht,

Afrim KRASNIQI,
Drejtor Ekzekutiv

REKOMANDIME MBI PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR

1. Në Kodin Zgjedhor, duhet të amendohet një dispozitë, e cila të përkufizojë përfundimisht qartazi dallimin midis veprimtarive shtetërore dhe atyre me karakter partiak dhe elektoral. Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë një katalog shterues, se cilat veprimtari konsiderohen shtetërore dhe cilat politike, duke parashikuar sanksione në rastet kur agjendat shtetërore shfrytëzohen gjatë fushatave zgjedhore për propagandë dhe premtime elektorale.
2. Kodi Zgjedhor duhet të amendohet për t'i prerë rrugën përfundimisht personalizimit të fushatave zgjedhore nga funksionarë publikë të cilët, duke pasur një post të lartë shtetëror, ushtrojnë vendimmarrje për të përshtatur agjendat dhe aktivitetet shtetërore për qëllime të promovimit indirekt të subjektit dhe figurave përfaqësuese politike gjatë fushatave zgjedhore, sidomos koncerteve, panairove, donacioneve, gara sportive, çmime dhe stimuj, etj.
3. Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil duhet të amendohet për të rregulluar përfundimisht statusin e “studentëve ekselentë” apo kategori të tjera, të cilat angazhohen përkohësisht në vitet elektorale si punonjës në institucionet shtetërore. Marrëdhëniet e punës të derisotme nuk kanë parashikuar në asnjë rast kategori të “stazhirëve”, “kursantëve” apo praktikantëve që atashohen në nivele të nëpunësisë civile. Rregullimi i punësimit dhe kritereve të parashikuara me ligj, do të parandalonte punësimet e përkohshme që kanë për qëllim trajtimin preferencial të të rinjve simpatizantë apo anëtarëve të forumeve politike.
4. Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil duhet të parashikojë në mënyrë eksplicite dhe përfundimtare, ndërprerjen e marrëdhënies së punës për cilindo kandidat të subjekteve politike që përfshihet në fushatë elektorale. Askush nuk mund të përfitojë të ardhura nga rroga shtetërore, për sa kohë figuron se nuk paraqitet në detyrë. Ky rregull duhet të jetë i përgjithshëm dhe çdo abuzim të përbëjë shpërdorim detyre, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.
5. Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil duhet të amendohen duke ndaluar përfundimisht mundësinë e zhvillimit të konkurseve apo lëvizjeve paralele në institucionet shtetërore gjatë fushatave elektorale. Në vitet zgjedhore konkurset të lejohen vetëm në rastet e deklarimeve paraprake të vendeve vakante që depozitohen në Departamentin e Administratës Publike (DAP).
6. Kodi Zgjedhor duhet të amendohet për të parandaluar dhe dënuar çdo veprimtari në vitet zgjedhore që ka për qëllim të ofrojë lehtësira sociale dhe financiare, shpërblime financiare, rritje pagash dhe pensionesh, amnisti fiskale ose penale që bëhen enkas dhe/ose të paplanifikuara për qëllime elektorale.
7. Legjislacionin duhet të përmirësohet për të pamundësuar që figurat politike, përfshirë ministra, kryeministri, kryetari i parlamentit, etj, të lëvizin gjatë fushatës elektorale të shoqëruar personalisht nga Garda e Republikës apo efektivë të Policisë, duke bërë ndarje të qartë midis detyrës për sigurimin e rendit dhe qetësisë publike me përdorimin e tyre në funksion të axhendës politike të zyrtarit përgjegjës.

8. Përmes Kodit Zgjedhor apo vendimmarrjeve të përcaktuara për KQZ duhet të aplikohet modeli i gjobave financiare për të gjitha partitë dhe kandidatët, të cilët shkelin heshtjen zgjedhore, përdorin fëmijët në fushatë, abuzojnë me postera apo materiale zgjedhore, nxisin konflikte apo promovojnë dhunën, etj, duke u bazuar në modelet e vendeve të tjera me sukses në këtë drejtim, siç është rasti i Kosovës.
9. Kodi Zgjedhor dhe legjislacioni duket të krijojë mekanizma konkretë dhe të qartë ndalues që individët me poste në administratë publike, kryesisht drejtues të enteve publike që supozohet se zgjidhen me konkurs dhe duhet të jenë të pavarur, të jenë njëherësh anëtarë të forumeve drejtuese të partive politike. Në funksion të këtij qëllimi, partitë duhet të deklarojnë në çdo kohë përbërjen zyrtare të sekretariatit, kryesive dhe të Asambleve/Këshillave Kombëtarë, si organet e tyre kryesore.
10. Kodi Zgjedhor, legjislacioni mbështetës dhe KQZ duket të përcaktojnë qartësisht listën dhe kategorinë e zyrtarëve qendrorë e lokalë, të cilët mund të jenë në konflikt interesi me kandidimin në zgjedhje, duke përcaktuar detyrimin se çdo zyrtar kandidat në zgjedhje ose anëtar i stafeve elektorale, të japë dorëheqje për periudhën zgjedhore nga funksioni i tij drejtues në ente shtetërore, drejtori apo institucione të tjera.
11. Kodi Zgjedhor të përcaktojë detyrimin që çdo institucion të ketë kurdoherë publike të dhënat mbi gjendjen faktike të personelit gjatë orarit të punës, për të shmangur çdo formë të përdorimit të administratës në funksion të fushatës, mitingjeve, protestave apo aktiviteteve me sfond politik.
12. Praktika e deklaruar më 2017, për shpalljen 6 muaj përpara zgjedhjeve të axhendës së aktiviteteve kryesore të ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të lartë, kryetarëve të bashkive dhe zyrtarëve lokalë, në mënyrë që të ketë mundësi monitorimi dhe të evitohen përdorimi i aktiviteteve shtetërore e zyrtare për efekt elektorale, do të duhet të sanksionohet me rregullore të veçantë ose me ligj.
13. Legjislacioni duhet t'i njohë të drejtën KQZ të ndërmarrë hapa administrative penalizues në ndalimin e çdo forme të përdorimit të siglave dhe simboleve partiake në zyrat dhe mjediset shtetërore, përfshirë edhe portalet e krijuara nga qeveria qendrore dhe lokale.
14. Kodi Zgjedhor, legjislacioni plotësues dhe KQZ duhet të përcaktojnë rregulla të qarta që bëjnë ndarjen midis individëve që përfshihen në administrimin zgjedhor në emër të partive politike ose kandidatëve (KZAZ, KQV, GN, etj), duke mos lejuar që struktura e pavarur zgjedhore të jetë njëherësh strukturë e deleguar politike ose të mos ketë përdorim të administratës nga kandidatët (p.sh, kryetarët e bashkive) në funksion të kandidimit të tyre
15. Përmes ndërhyrjes në ligj dhe vendimmarrjeve të KQZ duhet përcaktuar ndalimi i çdo forme të amnistisë fiskale 1-5 muaj përpara datës së zgjedhjeve, të ndalohen programet shtetërore (qendrore e lokale), të cilat në emër të mbështetjes sociale përkthehen në mbështetje financiare, si dhe të përcaktohet detyrimi që çdo parti e kandidat të bëjë publike jo vetëm donatorët, por edhe detyrimet e tyre në periudhën elektorale ndaj shtetit.

16. Vendimi i KM 2019 për kufizimin e të drejtës së pushtetit vendorë për të zhvilluar procese tenderimi dhe prokurimi financiar gjatë periudhës në prag e në fushatës elektorale do të duhet saktësuar me ligj dhe në rast pranimi si standard, të jetë i njëjtë edhe për qeverinë qendrore dhe institucionet e tjera me ndikime në procesin zgjedhor.
17. Legjislacioni duhet të ndalojë qartësisht çdo funksionar politik, kryeministër, ministër, deputet apo politikan tjetër, të bëjë deklarata politike dhe elektorale në takimet zyrtare e publike ku ka prani të institucioneve të pavarura, siç janë Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, Administrata Publike, shkollat dhe spitalet, kopshtet dhe çerdhet, universiteti dhe akademitë, etj.
18. Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Partitë Politike duhet të amendohen, duke i parashikuar të diferencuar për funksionarët politikë “buxhetin personal ose partiak i dedikuar elektoral” krahas buxhetit shtetëror të miratuar me ligj. Buxheti personal/partiak duhet të mbulojë çdo shpenzim gjatë fushatës elektorale dhe të jetë i planifikuar paraprakisht për t’u bërë lehtësisht subjekt kontrolli nëpërmjet analizave krahasimore të zërave të deklaruar, atyre të planifikuar dhe atyre të shpenzuar realisht. Një pasqyrë buxhetore e planifikuar duhet të depozitohet nga kandidatët para fillimit të fushatave elektorale pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ).
19. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë një vendim, nëpërmjet të cilit të ndalojë organizimin e tubimeve elektorale në mjediset e brendshme të godinave apo zyrave shtetërore. Gjithashtu ky ndalim duhet të jetë edhe për tubimet në sallat e godinave që figurojnë asete publike dhe që ofrojnë shërbime pa kontratë paraprake qiraje për aktivitetin.
20. Legjislacioni zgjedhor duhet të konsiderojë reklamë dhe aktivitet elektoral të gjitha aktet e ndihmave humanitare, shpërndarjes së librave dhe dhuratave, pjesëmarrjes në inaugurime, etj, nga ana e figurave të larta drejtuese politike dhe kandidatëve në zgjedhjet lokale apo parlamentare.
21. Legjislacioni duhet të konsiderojë si pjesë të reklamës politike çdo koncert publik, aktivitet kulturor e sportiv, etj, të organizuar gjatë fushatës elektorale dhe ku ka logo, flamuj, simbole, fjalime, përshëndetje apo apele politike nga figura drejtuese politike dhe kandidatë në fushatë.
22. Kodi Zgjedhor të amendohet duke përmirësuar përdorimin e të dhënave personale dhe shfrytëzimin e tyre për shantazh, propaganda dhe mesazhe politike. Gjithashtu përkatësia partiake dhe anëtarësia politike duhet të kategorizohen si të dhëna personale që nuk mund të përdoren apo përpunohen pa pëlqimin paraprak të individit.
23. Kodi Zgjedhor të amendohet për të rregulluar hapësirat mediatike të propagandës zgjedhore, duke trajtuar të gjitha burimet e difuzionit, përfshirë edhe portalet online dhe mediat sociale. Kodi duhet të parashikojë kriteret të përkufizuara qartë se cilat janë sulmet, denigrimet dhe shantazhet nëpërmjet përpunimit abuziv të lajmeve, propagandës apo “fake news” për të parandaluar deformimin dhe desinformimin e opinionit publik. Kodi dhe KQZ duhet të marrin për bazë çdo reklamë përmes medieve sociale apo në portale, në funksion të fushatës,

si dhe ta trajtojë atë me të njëjtën metodologji siç trajtohen raportime e medie tradicionale nga BMM.

24. Kodi Zgjedhor dhe KQZ duhet të marrin në konsideratë nevojën për t'i dhënë vlerë ligjore të njëjtë me angazhimin në mediat kryesore, edhe qëndrimeve dhe verimeve që individët kryejnë në mediat sociale dhe portalet online, sidomos për nëpunësit e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, punonjësit e sektorit publik, si dhe administratën zgjedhore.
25. Kodi Zgjedhor dhe BMM duhet të konsiderojnë reklamë elektorale, çdo dalje të politikanëve kandidatë apo drejtues politikë në emisione televizive jashtë edicionit të lajmeve. Gjithashtu ata duhet të konsiderojnë reklamë elektorale edhe çdo deklaram të bërë në mediat partiake në rrjetet sociale apo ato online.